



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 11.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **05.08.2025**, të parashtruar nga **NMA SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vlerësimi i Rrezikshmërinë në Punë dhe Trajtimi i Eksperteve, për MSh dhe Njësitë vartëse, IKSHPK, QKTGJK, DSHB, ISSH dhe Tre Inspektoratet”** me nr. prokurimi 206-25-4624-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE NMA SH.P.K. e dt. 05.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Vlerësimi i Rrezikshmërinë në Punë dhe Trajtimi i Eksperteve, për MSh dhe Njësitë vartëse, IKSHPK, QKTGJK, DSHB, ISSH dhe Tre Inspektoratet”** me nr. prokurimi 206-25-4624-2-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 01.08.2025;
2. **Shfuqizohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 01.08.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, e kthen në Rivlerësim aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE NMA SH.P.K. me datën 05.08.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vlerësimi i Rrezikshmërinë në Punë dhe Trajtimi i Eksperteve, për MSh dhe Njësitë vartëse, IKSHPK, QKTGJK, DSHB, ISSH dhe Tre Inspektoratet”** me nr. prokurimi 206-25-4624-2-2-1. Autoriteti Kontraktues sot me datë 11.08.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 59 i Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimet ankimore te OE ankues:

PRETENDIM ANKIMORE

Duke u bazuar në kriteret e DT dhe njoftimit për kontratë, ne si operator i plotësojmë të gjitha kriteret e stafit profesional bazuar në Licencat dhe vendimet për rilicencim nga Ministrit përkatëse MPMS/MFPT

Tenderi jonë nuk është vlerësuar drejt pasi që licencat e stafit janë të lëshuara nga institucionet publike bazuar (Ministrit kompetente), fillimisht Licencat për subjekte juridike dhe persona fizik janë lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe pas bashkimit të Ministrive, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është në kuadër të Ministrisë MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE (MFPT), duke u bazuar në:

- ✓ LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË
- ✓ RREGULLORE (MPMS) NR. 04/2018 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS (MPMS) NR. 02/2014 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR CERTIFIKIMIN DHE LICENCIMIN E PERSONAVE DHE INSTITUCIONEVE TË CILIT KRYEJNË PUNË NGA SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË, MËNYRËN, KUSHTET DHE PROGRAMIN PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL
- ✓ RREGULLORE (MPMS) NR. 01/2021 PËR KUALIFIKIMIN E PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, LICENCIMIN E KOMPANIVE TË SHËRBIMEVE DHE TRAJNIMEVE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË.

Duke u bazuar në ligjin dhe rregulloret e cekura më lartë ne i plotësojmë të gjitha kriteret sipas legjislacionit në fuqi.

Konsiderojmë që AK-ja ka shkel nenin 59 të LPP-së pasi që vlersimi, krahasimi dhe ekzaminimi i ofertës sonë nuk është bërë konform këtij neni.

Të gjitha certifikatat dhe Licencat e stafit të kompanisë sonë i kemi konform legjislacionit të cekur më lartë i cili është i aplikueshëm në Rep. e Kosovës.

Për qdo paqartësi AK-ja ka mundur të kërkojë informata shtesë nga Ministria përkatëse pra MFPT apo edhe nga ne si ofertues.

Ne si OE ofertues zotohemi se jemi të përgjegjshëm dhe i kemi plotësuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit pra dhe kapacitetin teknik ose profesional.

Përmes kësaj Kërkese Për Rishqyrtim kërkojmë nga AK që ta aprovon Kërkesen si të bazuar dhe që të marr:

VENDIM

ANULOHEM, Vendimi i AK-së dhe Lënda të kthehet në Rivlerësim, Në procesin e rivlerësimit të shpërblehemi me kontratë pasi që jemi OE i përgjegjshëm.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mund të jenë të konsiderueshme

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund te konstatojmë se pretendimi juaj ankimor është i bazuar dhe si i tille merret parasysh nga AK dhe lënda kthehet ne Rivlerësim.

Pas Kërkesës tuaj për Rishqyrtim, për sqarimin lendes ne kemi kërkuar me shkrim sqarim ne MFPT te Divizioni për Politikat e Sigurisë dhe Shëndetit ne Punë, kërkesa me email si me poshtë:

Te nderuar,

Po ju shkruaj ne Ministria e Shendetesise, nese mund te na sqaroni ne lidhje me çështjen e certifikimit/licencimit per Siguri dhe Shendet ne Pune, konkretisht na interesoj te dime:

Personat fizik (ekspertet), a pajisen vetem me Certifikata per Siguri dhe Shendet ne Pune nga MFPT, apo edhe me Licenca?

Pyetja jone eshte me qellim te sqarimit, se Licencat per Siguri dhe Shendet ne Pune a leshohen vetem per kompanite (OE) apo edhe per personat fizik.

Ju falenderojme paraprakishte dhe nese mund te na ktheni pergjigje sa me shpejte.

Përgjigja e dhënë nga MFPT te Divizioni për Politikat e Sigurisë dhe Shëndetit ne Punë:

Në lidhje me pyetjen tuaj për çështjen e certifikimit dhe licencimit në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP), sqarojmë si vijon:

- **Personat fizik** të cilët përfundojnë me sukses provimin pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), pajisen me **Certifikatën për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**, në përputhje me Ligjin, Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë si dhe me nenin 3 dhe 8 të Rregullores (MPMS) Nr.01/2021 për Kualifikimin e personave përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Licencat për veprimtari në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë lëshohen vetëm për **Kompanitë e Shërbimeve (që mirren me vlerësimin e riskut në vendin e punës) dhe Qendrat e Trajnimit (që merren me trajnimet e punëtorëve nga fusha e SSHP)**, të cilët plotësojnë kriteret dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Pra, licencimi nuk zbatohet për persona fizik, por vetëm për Qendrat e trajnimeve dhe Kompanitë e Shërbimeve.

Bazuar ne sqarimet e dhëna nga MFPT, shihet se profesionistet duhet te jene te pajisur me certifikata dhe jo me licenca, andaj mbi këtë bazë lënda kthehet ne Rivlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimi te këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit